



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 172/10 prot.,

Datë 10.03.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 374/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 256/2026, datë 13.02.2026 në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (shërbim)”, me nr. REF-69404-11-19-2025, me objekt “Shërbim fushate komunikimi/ndërgjegjesimi”, me fond limit: 9,978,000 (nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 04.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK me Nipt. K71903025A dhe adresë: Rruga “Shyqyri Berxolli”, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tiranë  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

*Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 13.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 25/2026, ku vendosi: [.....]

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (shërbim)”, me nr. REF-69404-11-19-2025, me objekt “Shërbim fushate komunikimi/ndërgjegjesimi”, me fond limit: 9,978,000 (nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 04.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ Optima Communication” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.” [...]*

I.2. Me shkresën nr. 8722 prot., datë 05.03.2026, protokolluar me tonën nr. 172/7prot., datë 09.03.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 256/2026 datë 13.02.2026.

**II**

**Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

## **Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 8722 prot., datë 05.03.2026, protokolluar me tonën nr. 172/7prot., datë 09.03.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 256/2026 datë 13.02.2026.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP Nr. 256/2026, datë 13.02.2026

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar (shërbim)”, me nr. REF-69404-11-19-2025, me objekt “Shërbim fushate komunikimi/ndërgjegjesimi”, me fond limit: 9,978,000 (nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 04.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

